| | | |
|---|---|---|
| | **KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**<br>SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA<br>MUNICIPALITY OF SUHAREKA | |

# PROCESVERBAL II/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2025 të Komitetit për Komunitete Suharekë

---

**Vendi:** **KK Suharekë**
**Zyra:** **Salla e Bordit të Drejtorëve**
**Data:** **24.02.2025**
**Ora :** **09:00**

---

**Prezentë:**

**Z. Denis Sofra - Kryesues**
*z.Nazim Shabanaj*
*znj.Aferdita Morina*
*z.Zek Berisha*
*znj.Melisa Shabanaj*
*z.Aziz Bytyqi*
*znj.Dorentina Zenelaj*

**Të pranishëm tjerë:**

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi z. Denis Sofra cili propozoi këtë:

**Rend dite**

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim aftashkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;**

3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;**

4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;**

5. **Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1**. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Denis Sofra** - e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet pika 1**

**Pika2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim aftashkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;**

**Denis Sofra-**laboron kete pike.
**Avni Bytyqi-**Përshendet të pranishmit,bëhet fjal për dy lokale në rrugën Brigada 123,Drejtoria për Pronë dhe Kadastër ka nisur procedurat për me i zhvillu procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurt.Këto lokale deri më tani kan qenë duke u shfrytëzuar mirpo ju ka kalu kontrata e qeras dhe drejtoria ka nisur procedurat.
**Denis Sofra-** e hedhë në votim pikën 2.

**Aprovohet pika 2**

**Pika 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;**

**Denis Sofra-**laboron kete pike.
**Avni Bytyqi-**Edhe këtu bëhet fjalë për vendosjen e panove reklamuese,në 5 rrugë kryesore në zonën urbane të qytetit dhe kjo është kërkes e Drejtorisë së Pronës.
**Denis Sofra-** e hedhë në votim pikën 3.

**Aprovohet pika 3**

**Pika 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;**

**Denis Sofra-**laboron kete pike.
**Avni Bytyqi-**Bëhet fjalë për një kërkesë të një banori të fshatit Gjinoc,të cilit i është djegur shtëpia,dhe kërkesa ka ardhë në zyrën e Kryetarit dhe Kryetari e ka adresu në Kuvend që të ndihmohet në vlerë prej 5000€,siç i kemi ndihmu dhe disa familje më herët.

**Denis Sofra-** e hedhë në votim pikën 4.

**Aprovohet pika 4**

**Pika 5. 5.Të ndryshme;**

**Habibe Bytyqi-**Përshendet të pranishmit,Në mbledhjen e kaluarë pas informatës që e ka dhën Doruntina kam marrë përsipër paka shumë të njoftohemi me rastin që e ka paraqitur,mbas takimit unë kam vizitu të gjitha insitucionet që kan të bëjnë me rastin e asaj marteses së hershëme të një vajzës se Komunitetit pakicë,sa i përket kontaktit me prindë ata kan vështirësi në komunikim.Kam kontaktu me Policinë,sa i përket rastit Policia me atë familje është duke u marrë me dhunë në familje.
**Denis Sofra**-Policia dhe Qendra për Punë Sociale është duke e kryer punën e tyre

.
Takimi përfundoi: 09:11